




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika-Odeljene za
Politike Pravosudnog Sistema, Slobodne Profesije I Statistiku- Department of Justice Sytem
Policies, Freelance Professions and Statistics

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.5/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr. 258/20, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija Kërveshi, palës ankuese , me përfaqësuar nga , Përmbaruesit privat, me datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 3000 (tremijë) euro , të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Odës së Përmbaruesve, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Pala ankuese me seli në përfaqësuar nga me datë 02.04.2025, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë , ndaj përmbaruesit privat duke parashtruar se përmbaruesi privat me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me lëndën përmbarimore, P. nr. 258/2020, ka kryer shkelje të dispozitave të LPP-së, duke i tejkaluar autorizimet e tij të përcaktuara me ligj. Kjo nga shkak se pasi i është refuzuar prapësimi konform

vendimit të gjykatës, ka paguar shumën prej 2,666,00 euro si garancion për ushtrimin e ankesës në shkallë të dytë dhe meqenëse edhe në shkallë të dytë e ka humbur rastin, përmbaruesi privat i ka bllokuar llogaritë e tij duke e inkasuar shumën totale për borxh veç se të paguar me garancion nga ana e tij si edhe shpenzimet përmbarimore.

Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore ka kryer shkelje disiplinore, ngase i njëjti është dashtë nga depozita e dhënë si garancion në gjykatë, ta inkasoj borxhin e jo të bllokoj llogaritë tjera të biznesit në total, pasi mjetet kanë qenë të deponuara në gjykatë për këtë rast. Pala pretendon që përmbaruesi konform LPP-së, nenit 78 është dashur që borxhin ta inkasoj përmes urdhër transferit drejtuar gjykatës të cilat mjete gjenden në arkën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Po ashtu, pala ankuese pretendon që Përmbaruesi privat ka kryer shkelje tjera disiplinore duke mos ia dorëzuar asnjëherë ekspertizën financiare dhe pasqyrën e shpenzimeve edhe pas shume kërkesave të palës ankuese që ti dërgohen këto dokumente. Pala ankuese pretendon që shuma e inkasuar është e lartë në raport me borxhin, sepse kur ia zbresim shumës së inkasuar prej 5,638,36, shumë e borxhit prej 2,666,00 euro del shuma 2,972.37 euro e kur ia heqim kësaj shume shumën e taksës përmbarimore e cila nuk mund të jetë më e madhe se 182.86 euro konform Udhëzimit Administrativ për taksa, ndërsa kur i heqim edhe shpenzimet përmbarimore prej jo më shumë se 130.000 euro konform UA për taksa, atëherë del që shuma e kamatës së inkasuar për kamatë, duhet të jetë 2,660.00 që i përafrohet borxhit kryesor, (krejt këto llogaritje pala pretendon që i ka bërë me hamendësim, sepse nuk ka pranuar ende pasqyrë të shpenzimeve). Ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore dhe ndërmarrjen e masave ndaj përmbaruesit.

Përmbaruesi në përgjigjen e tij ka deklaruar se sipas dispozitave të LPP-së, pas kthimit të lëndës nga gjykata e cila ka vendos sipas prapësimit dhe ankesës së debitorit, ka ndërmarrë veprimet përmbarimore me qëllim të zbatimit të përmbarimit. Në këtë kuptim është bërë bllokimi i llogarive deri në shumën e borxhit të debitorit, dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore. Pasi Përmbaruesi privat ka kuptuar se ka garancion të paguar në gjykatë nga ana e debitorit, gjykatës përmes konkluzionit i është drejtuar me kërkesën që të transferohet shuma e garancionit në llogari të veçantë të Përmbaruesit dhe nga ajo llogari më pas të paguhet borxhi i debitorit. Nga dorëzimi i kërkesës për pagesë të garancionit që ka qenë në muajin Janar 2025, deri në momentin që janë gjetur mjete në llogari të debitorit, për të përfunduar lëndën në tërësi, kanë kaluar dy muaj dhe nuk është paguar garancioni nga gjykata. Në kuptim të dispozitave të LPP-së, në momentin që Përmbaruesi është njoftuar nga banka që debitori ka mjete në llogari me të cilat do të përfundohej në tërësi borxhi, ka dërguar urdhër transfer për mbyllje të lëndës. Po atë ditë ka dërguar konkluzionin tjetër për gjykatë, me të cilin ka anuluar konkluzionin e mëparshëm me kërkesën për pagesë të shumës së garancionit. Debitori këto mjete tani i ka të disponueshme dhe mundet t'i tërheq nga gjykata. Kreditori nuk mund të dëmtohej edhe më shumë dhe të pritej t'i realizohej dëshira e debitorit, që Përmbaruesi privat t'ia kryejë shërbimin dhe t'i tërheq mjetet nga gjykata. Këto mjete debitori mundet t'i realizojë direkt nga gjykata. Sa i përket pretendimit

të dytë, i njehti nuk qëndron, pasi në momentin e parë përmbaruesi i ka dërguar debitorit shkresat e nevojshme me të cilat është njoftuar për shumën që i është tërhequr, dhe për çka është tërhequr. Për vendosje lidhur me ankesën e palës kreditore, Komisionit Dicipinor i ka ofruar në dispozicion shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh faktet e cekura më lartë, faktin se pala ankuese nuk ka prezentuar asnjë provë me të cilën do ta bënte të besueshëm pretendimin e tij; thëniet dhe provat e pakontestueshme të ofruara nga Përmbaruesi; duke pasur parasysh qëllimin e ligjit për trajtim të barabartë të palëve dhe mbrojtjen e interesave të tyre në mënyrë të barabartë, kërkoi nga Komisioni Dicipinor i Ministrisë së Drejtësisë, që të refuzojë Raportin për Fillimin e procedurës dicipline si të pa bazuar.

Në seancën e mbajtur përfaqësuesi i palës ankuese deklaroi se mbetet pranë ankesës së parashtruar, dhe komisionit ia dorëzoi ankesën plotësuese me shkrim ku i ka paraqitur vërejtjet e tij në përgjigjen e përmbaruesit. Potenco i se kur ka kontaktuar me përmbaruesin, i njehti është sjellur në mënyrë arrogante dhe pasi ka biseduar disa herë me Përmbaruesin, i njehti pas 12 -13 ditëve e ka kthyer shumën prej 895,60 euro. Për fund pala ankuese deklaroi se është i dëmtuar tej mase nga ky përmbarues, andaj konkretisht kërkoi nga komisioni që përmbaruesi ti kthejë shumën prej 2666 euro dhe që ti dërgoi raportet e ekspertizës të cilat asnjëherë nuk i ka pranuar, edhe pse i ka kërkuar dhe pret që përmbaruesi të dënohet ashtu siç e parasheh ligji.

Në seancën disiplinore përmbaruesi deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjegjes së dhënë me shkrim. Sa i përket pretendimeve të palës ankuese në këtë seancë që gjatë komunikimit me telefon ka pasur sjellje arrogante e njoftoj komisionin se nuk ka bërë ndonjë sjellje arrogante.

Lidhur me shumën prej 2666 euro të deponuar nga klienti në emër të garancionit për ankesë fillimisht ka tentuar ta kthejë nga gjykata për pagesë të borxhit, më shumë se dy muaj, por nuk i ka i paguar asnjëherë. Në anën tjetër, përmbaruesi ka deklaruar se ka vepruar dhe ka bllokuar llogaritë deri në lartësinë e borxhit sipas vendimit të Gjykatës shtuar këtyre edhe shpenzimet e procedurës. Duke qenë se debitori ka pasur mjete të mjaftueshme në banka për zbatim të përmbarimit dhe duke pasur parasysh që procedura përmbarimore është e natyrës urgjente dhe lënda është e vitit 2020, se kreditori po dëmtohet në vazhdimësi., përmbaruesi ka anuluar konkluzionin e gjykatës dhe pastaj ka debituar shumën nga llogaria në një bankë komerciale.

Komisioni vlerëson se në këtë rast nuk është kontestuese se përmbaruesi lëndor e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm- faturës. Pastaj nuk është kontestuese se në procedurë gjykata e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe debitori ka deponuar shumën e kërkuar nga gjykata me qëllim që të parashtroi ankesë në shkallën e dytë. Kontestuese në këtë çështje mbetet se veprimi përmbarimor i përmbaruesit privat me rastin e ekzekutimit të rastit, a do duhej që të obligimi të inkasohet nga depozita në gjykatë dhe të presë atë transfer nga gjykata sikurse edhe potencohet në praktikën gjyqësore që në rast të refuzimit të ankesës shuma e deponuar si

garanci, transferohet tek pala kreditore në emër të borgjit apo të vazhdoj me bllokim të llogarive tjera bankare të debitorëve.

Me nenin 367, paragrafi 1, nënparagrafet 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *“1.1 Nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj” dhe “1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit”.*

Komisioni, vlerëson brenda juridiksionit të tij se përmbaruesi privat në këtë rast ka bërë shkelje disiplinore në rastin e ndërmartjes së veprimit përmbarimor, në raport me palën ankuese, sepse pala ankuese e ka pasur të deponuar shumën në emër të garancionit e cila shuma duhet të trajtohet si shumë për obligimin në këtë lëndë e jo të bllokohen llogaritë për tërë atë shumë dhe njëherë të kërkohej transferi nga gjykata, ndërsa dikur anulimi i atij transferi dhe bllokim të llogarive, derisa mjetet janë në llogari të gjykatës. Me këtë veprim përmbaruesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 78, par.8 i LPP-së, e në raport me palën ankuese e ka tejkualuar autorizimin e tij të besuar me ligj dhe nuk iu ka përmbajtur ligjit, sepse ka ndërmarrë veprim përmbarimor jo në harmoni me dispozitat ligjore sa i përket asaj mase të mjeteve, ndërsa për diferencën eventuale ka mundur të trajtoj jashtë asaj shume të deponuar dhe ta njoftoj edhe debitorin me të gjitha detajet e obligimit, kamatës dhe diferencës përtej shumës së deponuar së bashku me shpenzimet tjera procedurale.

Komisioni me rastin e vendosjes në këtë rast, mori për bazë edhe pretendimin dhe përgjigjen e përmbaruesit privat.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit të shkaktuar ndaj palës ankuese, e cila do të ndikonte në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve përmbarimore, te përmbaruesi privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës. Ndërsa detyrimi se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 11 të Ligjit, nr. 08/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin, nr. 05/L-118, ku përcaktohet se: *“Neni 368 i ligjit bazik, paragrafi 3, togfjalëshi “në*

buxhetin e Republikës së Kosovës”, ndryshohen me togfjalëshin “në buxhetin e Odës së Përmbaruesve”, andaj gjoba e shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi duhet të paguhet në llogarinë e buxhetit të Odës së Përmbaruesve.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPSDPLS.nr.5/2025 datë 12.06.2025

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaci



KËSHILLË JURIDIKE:*Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.*